



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 37/08**

**Prishtinë, më 15.12.2008, ora 10:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka, Hajdin Abazi.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Naser Osmani.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Agim Krasniqi Drejtor i Buxhetit në MEF, Enver Hoxha Ministër i MASHT, Saša Rašić Ministër i MKK, Eduardo Ruxherio nga FMN, Teki Shala, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

**Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 26 nëntor 2008**
- 3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të organizatave buxhetore që kanë të bëjnë me Projektligjin nr. L-105 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Individuale**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar**
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë**
- 8. Të ndryshme.**

**Kryesuesi**, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 26 nëntor 2008**

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbali u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të organizatave buxhetore që kanë të bëjnë me Projektligjin nr. L-105 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009**

**Haki Shatri**, duke komentuar kërkesat e parashtruara buxhetore, njoftoi se për shumicën prej tyre është arritur pajtueshmëria. Pajtueshmëria është arritur për kërkesat e Komisionit të Pavarura për Miniera dhe Minerale dhe Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina ndaj të cilave kemi zvogëlim të tyre, ndërsa për kërkesën e Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit kemi rritje në kategorinë paga. Buxheti i Zyrës së Auditorit Gjeneral ka mbetur siç e ka miratuar Qeveria. Harmonizimi i tillë është bërë edhe me kërkesën e Kuvendit.

#### **3.1. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

**Kryesuesi**, ia dha fjalën Ministrit z. Enver Hoxha, për të arsyetuar kërkesën e parshtruar.

**Enver Hoxha, Ministër i MASHT-it**, theksoi se kërkesa e Ministrisë së Arsimit ka të bëjë me një rishpërndarje të shumës prej një 1 milion € nga shuma prej 3 milion eurove e paraparë në projektin kapital “Projekti për arsimin e lartë”. Kjo shumë do të ridestinohej në këtë formë, për projektet në vazhdimësi 400,000 €, 300.000€ për angazhimin e një kompanie për mbikëqyerjen e shkollave të ndërtuara, 200,000€ për blerjen e librave, ndërtimi i shkollës në Demjan të Gjakovës në vlerë prej 80.000€, si dhe vendosja e bustit në Shkollën e Mesme “Vëllezërit Frashëri” në Deçan në vlerë prej 20.000€.

**Haki Shatri**, njoftoi për një propozim të bërë me shkrim nga deputetja znj. Şinik lidhur me ndërtimin e një aneksi në shkollën fillore “Motrat Qiriazit” në Prizren në shumën prej 200.000€.

**Enver Hoxha, Ministër i MASHT**, lidhur me propozimin për shkollën në Prizren është menduar të bëhet kërkesa me rishikim të buxhetit, por nëse gjindet mundësia tani do të ishte zgjidhje e mirë.

**Kryesuesi**, duke pasur parasysh faktin se me këto kërkesës kemi të bëjmë me lëvizje të brendshme, përjashtimisht kërkesës për ndarjen e mjeteve për shkollën në Prizren, theksoi se pajtohet me ato.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

Miratohen kërkesa buxhetore e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ridestinimin e shumës prej 1 milion eurove nga shuma prej 3 milion eurove e paraparë në projektin kapital “Projekti për arsimin e lartë” në projektet ashtu siç janë paraparë me kërkesën e Ministrisë.

### 3.2. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim

**Kryesuesi**, ia dha fjalën Ministrit, z. Rašić që të arsyetoj kërkesën e parashtruar.

**Saša Rašić, Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim**, duke ditur rëndësinë që ka kjo Ministri, që merret drejtpërdrejtë me problemet e të gjitha komuniteteve, theksoi se me buxhetin e miratuar nga Qeveria është e pamundur të realizohen projekteve e parapara kapitale dhe të plotësohen nevojat e domosdoshme për komunitet.

**Haki Shatri**, propozoi që shuma e paraparë me buxhetin aktual prej 7,500,000€ të shpërndahet nëpër projekte pas përgatitjes dhe prezantimit të këtyre projekteve në bazë të formularëve standard.

**Agim Krasniqi**, njoftoi se kur kemi shqyrtuar kërkesat buxhetore, nuk kemi pasur ndonjë kërkesë me projektet individuale nga kjo Ministri. Megjithatë me vendimin që mund të marr Kuvendi dhe pas plotësimit të formularëve standard mund të bëhet shpërndarja e mjeteve të parapara nëpër projekte.

**Kryesuesi**, nga kërkesa shifet se kemi vetëm emërtime të projekteve dhe nuk ka sqarime tjera. Megjithëse është dashur që kërkesa e tillë të parashtrohej gjatë procesit të përgatitjes së rregullt buxhetor në Qeveri, u pajtua me propozimin që shuma të mbetet dhe pas prezantimit të projekteve të bëhet shpërndarja e tyre.

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi megjithëse se kjo Ministri ka pasur një imazh jo të mirë në menaxhimin e mjeteve buxhetore, u pajtua me propozimet që Ministria të përgatit projektet në bazë të formularëve standard dhe mëpastaj të bëhet shpërndarja e shumës së paraparë në buxhet nëpër këto projekte.

**Xhevdet Neziraj**, u pajtua me mendimin se kjo Ministri ka pasur një zë të keq në shpenzimin e buxhetit. Shumica e projekteve kanë shkuar për komunitetin serb. Nga kërkesa e prezantuar shifet se kemi projekte që janë vazhdimësi e këtij viti. Prandaj kërkoi që me rastin e hartimit dhe prezantimit të projekteve të mendohet për të gjitha komunitetet, gjithashtu të planifikohen mjete për kthimin e qytetareve nga diaspora.

**Kosara Nikolić**, kërkoi që mos të krahasohet puna e kësaj Ministrie me punën që është bërë në të kaluarën. Buxheti i miratuar nga Qeveria është shumë i vogël për të realizuar projektet e parapara për të gjitha komunitetet. Në këtë drejtim edhe Komisioni Evropian ka rekomanduar për rritje të buxhetit për projektet për kthimin. Kjo ministri me këtë udhëheqje po punon seriozisht dhe në mënyrën transparente për të realizuar projekte që shkojnë në të mirë të gjithë qytetarëve.

**Kryesuesi**, theksoi se nëse Ministria deri në rishikim të buxhetit tregohet e suksesshme në realizimin dhe menaxhimin e buxhetit do të shikohet mundësia për plotësimin e tij.

**Agim Krasniqi**, njoftoi se përveç këtij buxheti, mjete për minoritete janë paraparë edhe në kuadër të buxheteve komunale.

**Saša Rašić, Ministër i MKK**, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe vërejtjeve, theksoi se po shifet se për mjete shtesë të buxhetit nuk ka mundësi deri në rishikim. Ndërsa për kërkesën e dytë premtoi se do të përgatitet projektet me kodet e veçanta dhe se kjo do të bëhet gjatë kësaj faze të miratimi të buxhetit.

**Naser Osmani**, theksoi se raporti i Auditorit të Jashtëm ka gjetur shumë parregullsi në këtë Ministri, e që është nevojë e domosdoshme për sqarime për këto të gjetura. Pa këto sqarime theksoi se nuk do të votojë për këtë kërkesë.

**Kryesuesi**, për raportin e auditorit do të bisedojmë kur të vie koha e raportimeve, por se tani të vendosim për një nënndarje brenda buxhetit që është propozuar.

**Kosara Nikolic**, theksoi se kjo Ministri do të jetë shumë transparente në shpenzimin e mjeteve publike gjatë vitit 2009 dhe se do të prezantohen të gjitha raportet për mënyrën e shpenzimit të buxhetit, ku do të shihet edhe mënyra e realizimit të projekteve.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

Kërkohet nga Ministria për Komunitet dhe Kthim që të përgatit projektet kapitale konform formularëve standard për përgatitjen e kërkesave buxhetore për vitin 2009 që të mund të shpërndahen mjetet e parapara nëpër këto projekte.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Individuale**

**Kryesuesi**, theksoi se kemi të bëjë me Projektligjet në të cilat është bazuar edhe buxheti, prandaj me disa ndryshime të përgatitura nga përfaqësuesit e zyrës ligjore të MEF-it duke u bazuar në vërejtjet tona të bëra me rastin e shqyrtimi të parë të tij, të kërkohet nga Kuvendi që të miratojë atë.

**Haki Shatri**, theksoi se kemi të bëjë me katër projektligjet që kanë kaluar në shqyrtim të parë. Duke ditur faktin se kemi ndryshim vetëm të normave, edhe disa ndryshime tjera të vogla të kërkohet nga Kuvendi për miratimin e tyre.

**Riza Smaka**, kërkoi që të ndërrohet titulli në vend individuale të jetë personale, kjo është më e përshtatshme edhe në gjuhën angleze.

**Kosara Nikolic**, termi i punësuar në gjuhën serbe nuk është përkufizuar mirë, të ndryshohet.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **R E K O M A N D I M**

Miratohet projektligji për Tatimin në të Ardhurat Individuale dhe i rekomandohet Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Korporatave**

**Kryesuesi**, theksoi se kemi të bëjë me të njëjtën rast, prandaj me propozimet e ofruara të rekomandohet Kuvendit miratimi i tij.

**Hajdin Abazi**, kërkoi të merret parasysh çështja e tatimit të OJQ-ve, për arsye se me Ligjin për TVSH-së nuk precizohet kjo çështje.

**Riza Smaka**, propozoi që të ndryshohet titulli dhe të jetë: Projektligji për tatimin në të ardhurat e organizatave biznesore, sepse në këtë formë përfshije të gjitha organizatat biznesore.

**Eduardo Roxherio**, theksoi se çdo Ligj është gjithëpërfshirës, prandaj edhe me këtë ligj duhet trajtohet tatimi i OJQ-ve jo kjo të varet nga ligjet tjera, të specifikohen veprimtaria e tyre.

**Kryesuesi**, duke ditur faktin se me këtë ligj bëhen ndryshimi i normave tatimore dhe se në vitin tjetër që po hyjmë pritet të vie Ligji i ri i përpunuar mirë i cili do ta ndryshojë këtë ligj, nuk duhet lëshuar shumë në përmbajtje e tij.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

Miratohet projektligji për Tatimin në të Ardhurat Korporatave dhe i rekomandohet Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

#### **6. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar**

**Kryesuesi**, theksoi se është rast i ngjashëm si me dy projektligjet e mëparshme, prandaj me propozimet e ofruara, të rekomandohet Kuvendit për miratimin e tij.

**Hajdin Abazi**, kërkohet të sqarohet më mirë çështja e OJQ-ve duke ditur faktin se disa prej tyre në emër të bamirësisë kanë futur mallra, si rezultat i së cilës kanë realizuar përfitime për vete duke iu shmangur obligimeve tatimore.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

Miratohet projektligji për Tatimin mbi vlerën e shtuar dhe i rekomandohet Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

#### **7. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë.**

**Kryesuesi**, ia dha fjalën përfaqësuesit të shërbimit doganor që të merr fjalën për të ofruar sqarime për propozimet e ofruara lidhur me projektligjin në fjalë.

**Fahri Gashi**, njoftoi se e kanë lexuar draftin e propozuar dhe kanë vërejtur dy gabime teknike që nëse nuk korrigjohen mund të nxjerrin shumë probleme në punën e shërbimit doganor, prandaj propozoi që të bëhen këto ndryshime. Ndryshimet i parë ka të bëjnë me aneksin (a) ku propozohet që fjala “dhe“ të zëvendësohet me fjalën “deri”. Ndryshimi i dytë ka të bëjë me fusnotën (1) ku fjalia nenit 3 të Kodit të Akcizës, të ndryshohet në nenit 236 të Kodit doganor dhe të akcizave në Kosovë.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

Miratohet projektligji për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë dhe i rekomandohet Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

## 8. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë çështje për tu diskutuar.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Përgatitur nga  
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

---

Gani KOCI